



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 30

Tiranë – E premte, 16 shkurt 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 14/2024, datë 8.2.2024	Për miratimin e dekretit nr. 10, datë 13.1.2023, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 93/2022, ‘Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë’”..... 3155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 65, datë 14.2.2024	Për organizimin e zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit..... 3155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 14.2.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 65, datë 8.2.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i akseve rrugore ‘Unaza Lindore, loti II’ dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit””..... 3156
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 71, datë 14.2.2024	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – Zhvillimi urban”, ratifikuar me ligjin nr. 63/2019..... 3158
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 72, datë 14.2.2024	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillimi urban”, ratifikuar me ligjin nr. 64/2019..... 3161
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 14.2.2024	Për një shtesë dhe rialokim të numrit të punonjësve organikë në aparatin e disa njësive të qeverisjes qendrore për vitin 2024..... 3163
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 74, datë 14.2.2024	Për lirin nga detyra të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve..... 3163
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 14.2.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, të ndryshuar... 3164

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 14.2.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm”, të ndryshuar.....	3167
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 376, datë 28.12.2023	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin nëntor 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	3167
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 377, datë 26.12.2023	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme”.....	3169
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 378, datë 28.12.2023	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.....	3169
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 381, datë 28.12.2023	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	3170
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 382, datë 28.12.2023	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	3172
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 386, datë 28.12.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	3173
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 389, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k.....	3174
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 390, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k.....	3175
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 391, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Bistrica 3 Energy” sh.p.k.....	3176
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 392, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Bistrica 3 Energy” sh.p.k.....	3177
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 393, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k.....	3178
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 394, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k.....	3180
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 395, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Hdropower Elektrik” sh.p.k.....	3181
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 396, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Hdropower Elektrik” sh.p.k.....	3182

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 397, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Korkis 2009” sh.p.k.....	3183
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 398, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Reka Energy” sh.p.k.....	3184
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 399, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “E.T.H-H” sh.p.k.....	3185
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 400, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k.....	3186
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 401, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Bardhgjana” sh.p.k.....	3187
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 402, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “SIMA-COM” sh.p.k.....	3188
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 403, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k.....	3189
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 404, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k.....	3191
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 405, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k.....	3192
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 406, datë 28.12.2023	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Cosmogral” sh.p.k.....	3193

**VENDIM**
Nr. 14/2024**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT NR. 10,**
DATË 13.1.2023, TË PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E LIGJIT
NR. 93/2022, ‘PËR DEKORATAT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 85 të Kushtetutës dhe
nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Miratimin e dekretit nr. 10, datë 13.1.2023, të
Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr.
93/2022, ‘Për dekoratat në Republikën e
Shqipërisë”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 8.2.2024.

VENDIM
Nr. 65, datë 14.2.2024**PËR ORGANIZIMIN E ZYRAVE**
VENDORE TË AVOKATURËS
SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të
pikës 1.5, të nenit 11, të ligjit nr. 10 018, datë
13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të
ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli
i Ministrave

VENDOSI:

1. Avokatura e Shtetit në nivel vendor
organizohet në 6 (gjashtë) zyra me kompetencat
tokësore, si më poshtë vijon:

a) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit
Gjirokastrë, me kompetencë tokësore në:

i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Gjirokastrë;

ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Sarandë;

b) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Korçë,
me kompetencë tokësore në Gjykatën e Shkallës së
Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

c) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Lushnjë,
me kompetencë tokësore në:

i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Berat;

ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Durrës;

iii. Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë
Lushnjë.

ç) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit
Shkodër, me kompetencë tokësore në:

i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Kukës;

ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Lezhë;

iii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Shkodër.

d) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Tiranë,
me kompetencë tokësore, në:

i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Dibër;

ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Elbasan;

iii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Tiranë;

iv. Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë
Tiranë;

v. Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të
Përgjithshëm Tiranë;

vi. Gjykatën Administrative të Apelit.

dh) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Vlorë,
me kompetencë tokësore në:

i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Fier;

ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Vlorë.

2. Ngarkohet Avokatura e Shtetit për zbatimin e
këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren
Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM
Nr. 66, datë 14.2.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 65, DATË 8.2.2023, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I AKSEVE
RRUGORE ‘UNAZA LINDORE, LOTI II’
DHE PROBLEMATIKAT E RRUGËVE
DYTËSORE TË OBJEKTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 65, datë 8.2.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 3, vlera “... 51 783 837.3 (pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë tre) lekë ...” zëvendësohet me “... 52 861 542.3 (pesëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e dy mijë pikë tre) lekë ...”.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 52 861 542.3 (pesëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e dy mijë pikë tre) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) vlera prej 51 783 837.3 (pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë tre) lekësh, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar;

b) vlera prej 1 077 705 (një milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesë) lekësh, nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

c) në pikën 10, pas emërimit “Agjencia Shtetërore e Kadastrës ...” shtohet “... Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1...”.

ç) tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

4. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



LISTA SHITESË E PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I AKSEVE RRUGORE ‘UNAZA LINDORE, LOTI II’ DHE PROBLEMATIKAT E RRUGËVE DYTËSORE TË OBJEKTIT”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (sipas kartelës së pasurisë)				TË DHËNAT PËR SHPRONËSIM									Konfirmimet	SHËNIME	Adresa	
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Shpronësim tokë “arë”			Shpronësim tokë “truall”	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)	Objekt social-ekonomik		VLERA TOTALE (lekë)				
								Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)			Sip. e ndërtesës	Vlera e preventivit					
11	Besnik	Haxhi	Balla	1604	45/13	truall	500				107	5140	549980				549980	Konfirmuar nga ASHK-ja	Shënim. Seksioni. E: “Godinë banimi 2kat + 1 kat nën tokë +109.5m² katit përdhe =108.1 m² sip verande=30.1 sip kat i parë 108.1m² sip verande 36.5 sip papafingo=80.5m² sip.verande=19.5m² sip.katit përdhe objekt ndihmës=35.3m²”. Objekti i banimit sipas dokumentacionit të lëshuar nga ASHK-ja nuk preket nga shpronësimi.	Tiranë, Shkozë
12	Nazif	Tahir	Hate	3976	236/193	truall	20				6	479	2874	15.2	432973.98		435848	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë
13	Tahir	Nazif	Hate	3976	234/24	truall	450				59	479	28261				28261	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë
	Artur	Novruz	Hysenaj	3976	234/24	truall	450				59	479	28261				28261	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë
	Ajet	Novruz	Hysenaj	3976	234/24	truall	450				59	479	28261				28261	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë
14	Halim	Tahir	Hate	3976	236/13	arë	600	25	448	11200							11200	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë
15	Besnik	Haxhi	Balla	1604	45/11	arë	930	117	448	52416							52416	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Surrat
Vlera totale																	1077705			



VENDIM

Nr. 71, datë 14.2.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË KONTRATËS
FINANCIARE, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR
PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA –
ZHVILLIMI URBAN”, RATIFIKUAR ME
LIGJIN NR. 63/2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillimi urban”, ratifikuar me ligjin nr. 63/2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

[Letra me kokë e BEI-t]

ME KORRIER

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”)

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3,
Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
E-mail: sekretariamin@finance.gov.al

Luksemburg, 20 november 2023

JU/OPS-POL/OEU-B/SB/ng/2023-15559

**Lënda: SHTRATI I LUMIT LANA –
RIZHVILLIMI URBAN**

**Numri i veprimit (Serapis N°): 2016-1020;
numri i kontratës (Fl N°): 87316**

Faqe | 3158

Kontratë financiare ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve (**“Banka”**) dhe Huamarrësit, datë 5 korrik 2019, me kontratën numër 87316 (**“Kontrata financiare”**)

MARRËVESHJE NDRYSHUESE N°1

Të nderuar zotërinj,
I referohemi kontratës financiare,

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1 Në këtë marrëveshje ndryshuese (**“Marrëveshja ndryshuese”**):

“Datë e hyrjes në fuqi” nënkupton:

Datën kur Banka konfirmon (duke përfshirë me postë elektronike ose mjete të tjera elektronike) ndaj Huamarrësit se Banka ka marrë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të:

a) 2 (dy) origjinale të kësaj letre në format të printuar në përputhje me dispozitat e nenit 5 (*Shkëmbimi i origjinaleve*) të kësaj letre, të nënshkruar sipas rregullave nga Huamarrësi;

b) konfirmimin me shkrim të Huamarrësit për përfundimin e procedurave të tij të brendshme që kërkojnë për ta bërë këtë marrëveshje ndryshuese efektive.

1.2 Me përjashtim të rasteve kur konteksti kërkon ndryshe ose nëse përcaktohet ndryshe, termat e përkufizuara në kontratën financiare dhe shprehjet e përdorura në kontratën financiare kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë marrëveshje ndryshuese.

1.3 Parimet e interpretimit të përcaktuara në kontratën financiare kanë të njëjtin efekt sikur të përcaktoheshin në këtë marrëveshje ndryshuese.

1.4 Çdo referencë për një “nen” ose “skedul” është, përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe ose përcaktohet ndryshe, një referencë për një nen ose një skedul të kësaj marrëveshje ndryshuese.

1.5 Titujt e nenit ose skedulit janë vetëm për lehtësi referimi.

1.6. Me efekt nga data e hyrjes në fuqi, çdo referencë në kontratën financiare ndaj “kësaj kontrate” (ose referenca të tjera të ngjashme) lexohet dhe interpretohet si një referencë ndaj kontratës financiare, të ndryshuar nga kjo marrëveshje ndryshuese.

1.7 Skeduli në këtë marrëveshje ndryshuese formon një pjesë integrale të kësaj marrëveshje ndryshuese.



2. NDRYSHIMET NË KONTRATËN FINANCIARE

Me efekt nga data e hyrjes në fuqi, kontrata financiare ndryshohet siç përcaktohet më poshtë:

a) Përkufizimi i “Data përfundimtare e disponibilitetit” në seksionin “Përkufizimet” të kontratës financiare fshihet në tërësinë e saj dhe zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“Data përfundimtare e disponibilitetit” nënkupton datën 31 dhjetor 2026.

b) Neni 1.4.D (Kësti i fundit) i kontratës financiare fshihet në tërësinë e saj dhe zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“1.4 D Kësti i fundit

Disbursimi i Këstit të fundit është sipas kushtit që Banka ka marrë në ose përpara datës që përkon 5 (pesë) ditë-punë përpara datës së caktuar të disbursimit për këstin e propozuar, dëshmi të pranueshme për statusin e zbatimit të rrjetit të sipërm të kanalizimit të lumit Lana, duke përfshirë Impiantin e Trajtit të Ujërave. Ky status i implementimit duhet të garantojë që kolektorët e ujërave të zeza të përfshira në Projekt do të integrohen në projektin e trajtimit të ujërave të zeza në zbatim, përpara përmbylljes së realizimit të shtratit të lumit Lana – Rrëzëvillimi Urban.”;

c) Paragrafi “Për Bankën” me të dhënat e Bankës për njoftimet në nenin 12.1.B (Adresa) të kontratës financiare, zëvendësohet me të dhënat e mëposhtme:

“Për Bankën: Në vëmendje të: GLO/-/ENL

100 boulevard Konrad Adenauer L-2950

Luxembourg

Faksimile nr.: +352 4379 58417

Adresa e emailit: glo_enl@eib.org”.

d) Seksioni “Kalendar” i skedulit A.1 (Përshkrimi teknik) i kontratës financiare, lexohet si vijon:

“Projekti do të ndërtohet gjatë periudhës 2023–2026.”;

e) Afati për dorëzimin e raportit përmbyllës të realizimit të Projektit, të përcaktuar në seksionin 4 (Informacioni mbi përfundimin e punimeve dhe viti i parë i funksionimit) të skedulit A.2 (Informacioni për Projektin që duhet të dërgohet në Bankë dhe metoda e dërgimit) të kontratës financiare, zgjatet deri në datën 31 mars 2028.

f) Afati për dorëzimin e përditësimit mbi indikatorët monitorues, të përcaktuar në seksionin 5 (Informacioni kërket 3 vjet pas raportit përmbyllës të realizimit të Projektit) të skedulit A.2 (Informacioni për Projektin që duhet të dërgohet në bankë dhe metoda e dërgimit) të kontratës financiare, zgjatet deri në datën 31 mars 2031.

g) Skeduli B (Përkufizimi i EURIBOR) i kontratës financiare fshihet në tërësinë e saj dhe zëvendësohet me skedulin A (Përkufizimi i EURIBOR) në këtë marrëveshje ndryshuese. Numri “Skeduli B” për këtë skedul të ri në kontratën financiare duhet të ruhet.

3. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

3.1. Lidhur me faktet dhe rrethanat ekzistuese në:

a) datën kur Huamarrësi kundër – nënshkruan këtë marrëveshje ndryshuese; dhe

b) datën e hyrjes në fuqi,

Huamarrësi jep si më poshtë përfaqësimet dhe garancitë që çmohen të përsëritura sipas dhe në bazë të nenit 6.10 (Përfaqësimet dhe garancitë e përgjithshme) të kontratës financiare sikur çdo referencë në këto përfaqësime dhe garanci në “këtë kontratë” ka përfshirë një referencë në: i) kontratën financiare, të ndryshuar nga kjo marrëveshje ndryshuese; dhe ii) këtë marrëveshje ndryshuese.

4. TË NDRYSHME

4.1 Përveç në përputhje me dispozitat e nenit 2 (Ndryshimet në kontratën financiare) të kësaj letre, asgjë në këtë marrëveshje ndryshuese nuk ndikon në të drejtat e Bankës në lidhje me ndodhinë e një ngjarjeje mospërmbyllëse ose shkelje (sido që të përshkruhet) ose mospajtueshmëri në lidhje me kontratën financiare, duke përfshirë pa kufizim çdo ngjarje mospërmbyllëse ose shkelje (sido që të përshkruhet) ose mospajtueshmëri me kontratën financiare, që nuk është zbuluar nga Huamarrësi me shkrim para datës së kësaj marrëveshje ndryshuese ose që lind më ose pas datës së kësaj marrëveshje ndryshuese.

4.2 Dispozitat e kontratës financiare, me përjashtim të ndryshimeve në këtë marrëveshje ndryshuese, do të vazhdojnë në fuqi dhe efekt të plotë. Kjo marrëveshje ndryshuese nuk është (dhe nuk do të konsiderohet të jetë) një pëlqim, marrëveshje, ndryshim ose heqje dorë në lidhje me ndonjë term, dispozitë ose kusht të kontratës financiare, përveç siç është rënë dakord shprehimisht në të. Banka rezervon çdo të drejtë ose mjet tjetër ligjor që mund të ketë aktualisht ose më pas.

4.3 Kjo marrëveshje ndryshuese nuk sjell rinovim apo ka ndonjë efekt rinovues në kontratën financiare.

4.4 Banka lëshon këtë marrëveshje ndryshuese duke vepruar në mbështetje të informacionit të dhënë Bankës nga Huamarrësi deri në datën e



atyshme, në lidhje me të tilla çështje nëse ato janë të vërteta, të plota dhe të sakta. Do të jetë pa paragjykim ndaj çdo të drejte që Banka mund të ketë në çdo kohë në lidhje me ndonjë rrethanë ose çështje përveç atyre që referohen në mënyrë specifike në këtë marrëveshje ndryshuese ose në lidhje me një informacion të tillë nëse nuk është i vërtetë, i plotë dhe i saktë, të drejtat e të cilave do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

4.5 Huamarrësi do të kryejë, me kërkesë të Bankës dhe me shpenzimet e veta, të gjitha veprimet dhe hapat e nevojshme ose të dëshirueshme për të vënë në zbatim ndryshimet e kryera ose që do të kryhen në përputhje me këtë marrëveshje ndryshuese.

4.6 Palët në këtë marrëveshje ndryshuese pranojnë dhe bien dakord që çdo shkelje e kësaj marrëveshje ndryshuese, duke përfshirë (pa kufizim) çdo përfaqësim në këtë marrëveshje Ndryshuese që është ose bëhet i pasaktë, i paplotë ose çorientues në çdo aspekt material, përbën një “Ngjarje Mospërbushëse” sipas kontratës financiare.

4.7 Dispozitat e nenit 10.4 (*Mosbeqja dorë*), 11.2 (*Juridiksioni*), 11.3 (*Vendi i performancës*), 11.6 (*Pavlefshmëria*), 11.7 (*Amendamentet*), 11.8 (*Kopjet*), 12.1 (*Njoftimet*) të kontratës financiare do të përfshihen në këtë marrëveshje ndryshuese sikur të përcaktoheshin plotësisht në këtë marrëveshje ndryshuese dhe sikur referencat në këto klauzola ndaj “kësaj kontrate” janë referenca ndaj kësaj letre.

5. SHKËMBIMI I ORIGJINALEVE

Nëse jeni dakord me sa më lart, ju lutem kthejini Bankës me postë të regjistruar ose korrier 2 (dy) origjinale bashkëlidhur në format të printuar të kësaj letre, të shënuar në vëmendje të z. *Alessandro Cagnato*, Departamenti Juridik, i sigluar në çdo faqe, me datë dhe të nënshkruar sipas rregullave në emër dhe për llogari të Përfutuesit.

Me respekt,

BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

Matteo Rivellini
Drejtnes divizioni

Anne-France CATOIR
Këshilltar ligjor

Rënë dakord dhe pranuar për dhe në emër të:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në cilësinë e Huamarrësit

Emri: ERVIN METE

Pozicioni: MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Datë: 13.12.2023

Skeduli A

Përkufizimi i EURIBOR-it

EURIBOR

“EURIBOR” nënkupton:

a) në lidhje me një periudhë përkatëse prej më pak se një muaj, normën e publikuar të EURIBOR-it (siç përcaktohet më poshtë) për një periudhë njëmuajore;

b) në lidhje me një periudhë përkatëse prej një muaji ose më shumë për të cilën disponohet një Normë e publikuar e EURIBOR-it, norma e zbatueshme e EURIBOR-it e publikuar për një afat për numrin korrespondues të muajve; dhe

c) në lidhje me një periudhë përkatëse prej më shumë se një muaj për të cilën nuk disponohet një normë e publikuar e EURIBOR-it, norma që rezulton nga një interpolim linear, duke iu referuar dy normave të publikuara të EURIBOR-it, njëra prej të cilave është e zbatueshme për një periudhë tjetër më të shkurtër dhe tjetra për një periudhë më të gjatë sesa kohëzgjatja e periudhës përkatëse,

(periudha për të cilën është marrë norma ose nga e cila janë interpoluar normat, referohet si “**Periudha përfaqësuese**”).

Për qëllimet e paragrafëve “a” deri “c” më sipër:

i. “**e disponueshme**” nënkupton normat, për maturime të caktuara që janë llogaritur dhe publikuar nga Global Rate Set Systems Ltd (GRSS) ose ofrues të tillë shërbimesh të përzgjedhur nga Instituti Evropian i Tregjeve të Parasë (EMMI) ose çdo pasues i funksionit të EMMI-t, siç përcaktohet nga Banka; dhe

ii. “**Normë e publikuar e EURIBOR-it**” nënkupton normën e interesit për depozitat në EURO për periudhën përkatëse të publikuar në orën 11:00 paradite me orën e Brukselit, ose në një kohë të mëvonshme të pranueshme për Bankën në ditën (“Data e rivendosjes”) që bie 2 (dy) ditë përkatëse pune përpara ditës së parë të periudhës përkatëse, në faqen Reuters EURIBOR 01 ose në faqen pasuese të saj ose, nëse kjo nuk ndodh, me çdo mjet tjetër publikimi të zgjedhur për këtë qëllim nga Banka.

Nëse kjo normë Euribor-i nuk publikohet, Banka do t’iu kërkojë zyrtare kryesore të katër



bankave kryesore në eurozonë, të përzgjedhura nga Banka, që të përcaktojnë normën me të cilën ofrohen depozitat në euro në një shumë të krahasueshme nga secila prej tyre, rreth orës 11:00 paradite me orën e Brukselit në datën e rivendosjes për bankat kryesore në tregun ndërbankar të eurozonës për një periudhë të njëjtë me periudhën përfaqësuese. Nëse ofrohen të paktën 2 (dy) kuotime, norma për atë datë rivendosjeje është mesatarja aritmetike e kuotimeve. Nëse nuk jepen kuota të mjaftueshme siç nevojitet, norma për atë datë rivendosjeje është mesatarja aritmetike e normave të kuotuar nga bankat kryesore në eurozonë, të përzgjedhura nga Banka, rreth orës 11:00 paradite me orën e Brukselit, në datën që bie 2 (dy) ditë përkatëse pune pas datës së rivendosjes, për huat në EURO në një shumë të krahasueshme me bankat kryesore evropiane për një periudhë të njëjtë me periudhën përfaqësuese. Banka informon Huamarrësin pa vonesë për kuotimet e marra nga Banka.

Të gjitha përqindjet që rezultojnë nga çdo llogaritje e përmendur në këtë skedul do të rrumbullakosen, nëse është e nevojshme, në një të mijtën e pikës më të afërt të përqindjes, me gjysmat e rrumbullakosura.

Nëse ndonjë nga dispozitat e mësipërme bie në kundërshtim me dispozitat e miratuara nën kujdesin e EMMI-t (ose ndonjë pasuesi të atij funksioni të EMMI-it siç përcaktohet nga Banka) në lidhje me EURIBOR-in, me anë të një njoftimi drejtuar Huamarrësit, Banka mund të ndryshojë dispozitën që të jetë në përputhje me dispozitat e tjera.

Nëse norma e publikuar e EURIBOR-it bëhet përgjithmonë e padisponueshme, norma e zëvendësimit të EURIBOR-it do të jetë norma (duke përfshirë çdo ndryshim ose rregullim) e rekomanduar zyrtarisht nga: i) grupi i punës për normat pa risk të euros të vendosura nga Banka Qendrore Evropiane (BQE), Autoriteti i Shërbimeve dhe Tregjeve Financiare (FSMA), Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjeve (ESMA) dhe Komisioni Evropian; ose ii) Instituti Evropian i Tregut të Parasë, si administrator i EURIBOR-it; ose iii) autoriteti kompetent përgjegjës sipas Rregullores (BE) 2016/1011 për mbikëqyrjen e Institutit Evropian të Tregut të Parasë, si administrator i EURIBOR-it; iv) autoritetet kompetente kombëtare të përcaktuara sipas

Rregullores (BE) 2016/1011; ose v) Banka Qendrore Evropiane.

Nëse nuk disponohet asnjë normë e publikuar e EURIBOR-it dhe/ose normë zëvendësimi EURIBOR-i siç parashikohet më sipër, EURIBOR do të jetë norma (e shprehur si përqindje për çdo vit) e cila përcaktohet nga Banka si kosto gjithëpërfshirëse për Bankën për financimin e transhit përkatës bazuar në normën referuese të Bankës të krijuar në nivel të brendshëm në atë kohë ose një metodë alternative e përcaktimit të normës, e përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga Banka.

VENDIM

Nr. 72, datë 14.2.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE NR. 1 TË
MARRËVESHJES SË GRANTIT,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR
PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA –
ZHVILLIMI URBAN”, RATIFIKUAR ME
LIGJIN NR. 64/2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillimi urban”, ratifikuar me ligjin nr. 64/2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



[Letra me kokë e BEI-t]

ME KORRIER

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (“Përfituesi”)

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3,
Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Email: sekretariamin@finance.gov.al

Luxemburg, 20 november 2023

JU/OPS-[POL/OEU-B/SB/ng/2023-15566

Lënda: SHTRATI I LUMIT LANA –
RIZHVILLIMI URBAN

Numri i veprimit (Serapis N°): 2016-1020;
Numri i kontratës (FI N°): 91307

Marrëveshje Granti ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve (“Banka”) dhe Përfituesit, datë 5 korrik 2019, me kontratën numër 91307 (“Marrëveshja e Grantit”)

Marrëveshje Ndryshuese N°1

Të nderuar zotërinj,

I referohemi Marrëveshjes së Grantit.

PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

Në këtë Marrëveshje Ndryshuese (“**Marrëveshje Ndryshuese**”):

“Datë e hyrjes në fuqi” nënkupton:

datën kur Banka konfirmon (duke përfshirë me postë elektronike ose mjete të tjera elektronike) ndaj Përfituesit se Banka ka marrë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të:

a) 2 (dy) origjinale të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, në format të printuar, në përputhje me dispozitat e nenit 4 (Shkëmbimi i Origjinaleve) të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, të nënshkruar sipas rregullave nga Përfituesi; dhe

b) konfirmimin me shkrim të Përfituesit për përfundimin e procedurave të tij të brendshme që kërkojnë për ta bërë këtë Marrëveshje Ndryshuese efektive.

Me përjashtim të rasteve kur konteksti kërkon ndryshe ose nëse përcaktohet ndryshe, termat e përkufizuara në Marrëveshjen e Grantit dhe shprehjet e përdorura në të kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë Marrëveshje Ndryshuese.

Me efekt nga Data e Hyrjes në Fuqi, çdo

referencë në Marrëveshjen e Grantit ndaj “kësaj Marrëveshjeje” (ose referenca të tjera të ngjashme) lexohet dhe interpretohet si një referencë ndaj Marrëveshjes së Grantit, të ndryshuar nga kjo Marrëveshje Ndryshuese.

NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN E GRANTIT

Me efekt nga Data e Hyrjes në Fuqi, Marrëveshja e Grantit ndryshohet siç përcaktohet më poshtë:

a) Pika “i”, në nenin 2(2) të Marrëveshjes së Grantit zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm dhe, sipas rrethanave, Data e Përfundimit duhet të zgjatet deri në datën 31 dhjetor 2026:

“i) 31 dhjetor 2026 (“**Data e Përfundimit**”) ose...”;

b) Paragrafi “Për Bankën” me të dhënat e Bankës për njoftimet në nenin 18(3) të Marrëveshjes së Grantit, zëvendësohet me të dhënat e mëposhtme:

“Për Bankën: *Në vëmendje të: GLO/-/ENL
100 boulevard “Konrad Adenauer”
L-2950
Luxembourg
Faksimile nr.: +352 4379 58417
Adresa e email-it: glo_enl@eib.org”.*

TË NDRYSHME

Dispozitat e Marrëveshjes së Grantit, me përjashtim të ndryshimeve në këtë Marrëveshje Ndryshuese, do të vazhdojnë në fuqi dhe efekt të plotë. Kjo Marrëveshje Ndryshuese nuk është (dhe nuk do të konsiderohet të jetë) një pëlqim, marrëveshje, ndryshim ose heqje dorë në lidhje me ndonjë term, dispozitë ose kusht të Marrëveshjes së Grantit, përveç siç është rënë dakord shprehimisht në të. Banka rezervon çdo të drejtë ose mjet tjetër ligjor që mund të ketë aktualisht ose më pas.

Me kërkesë të Bankës dhe me shpenzimet e veta, Huamarrësi kryen të gjitha veprimet dhe hapat e nevojshëm ose të dëshirueshëm për të vënë në zbatim ndryshimet e kryera ose që do të kryhen në përputhje me këtë Marrëveshje Ndryshuese.

Përfituesi i vërteton Bankës se të gjitha përfaqësimet dhe garancitë që do të bëhen nga Përfituesi diku tjetër në Marrëveshjen e Grantit, janë të vërteta në të gjitha aspektet në datën e nënshkrimit të kësaj **Marrëveshjeje Ndryshuese**



nga Përfituesi dhe në Datën e Hyrjes në fuqi.

Dispozitat e nenit 17 (*Ligji Rregullues dhe juridiksioni*) të Marrëveshjes së Grantit do të përfshihen në këtë Marrëveshje Ndryshuese, sikur të përcaktoheshin plotësisht në këtë Marrëveshje Ndryshuese dhe sikur referencat në këto klauzola ndaj “kësaj Marrëveshjeje” janë referenca ndaj kësaj **Marrëveshjeje Ndryshuese**.

SHKËMBIMI I ORIGJINALEVE

Nëse jeni dakord me sa më lart, ju lutem kthejini Bankës, me postë të regjistruar ose korrier, 2 (dy) origjinale bashkëlidhur, në format të printuar, të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, të shënuar në vëmendje të z. *Alessandro Cagnato*, Departamenti Juridik, i sigluar në çdo faqe, me datë dhe të nënshkruar sipas rregullave në emër dhe për llogari të Përfituesit.

Me respekt,

BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

Matteo Rivellini

Drejtues Divizioni

Anne-France Catoir

Këshilltar Ligjor

Rënë dakord dhe pranuar për dhe në emër të:
Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
në cilësinë e Përfituesit

Emri: Ervin Mete

Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Data: 13.12.2023

VENDIM

Nr. 73, datë 14.2.2024

PËR NJË SHITESË DHE RIALOKIM TË NUMRIT TË PUNONJËSVE ORGANIKË NË APARATIN E DISA NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të ministrisë përgjegjëse për financat, miratuar në buxhetin e vitit 2024, reduktohet me 113 (njëqind e trembëdhjetë) punonjës.

2. Numri i punonjësve të aparatit të ministrisë përgjegjëse për kulturën, miratuar në buxhetin e vitit 2024, reduktohet me 91 (nëntëdhjetë e një) punonjës.

3. Numri i punonjësve rezervë të buxhetit të miratuar për vitin 2024 reduktohet me 71 (shtatëdhjetë e një) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve rezervë në 29 (njëzet e nëntë) veta.

4. Numri i punonjësve të përmendur në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, alokohet në aparatet e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, kulturën dhe inovacionin, dhe numri i punonjësve për këtë ministri bëhet 275 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë) veta.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 74, datë 14.2.2024

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Admir Abrija, drejtor i përgjithshëm i Burgjeve, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku



VENDIM
Nr. 75, datë 14.2.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 469, DATË 26.7.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË
BOTIMEVE PËR DIASPORËN”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Krijimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën (në vijim “QBD”), si person juridik publik buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin.”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Misioni i Qendrës së Botimeve për Diasporën është mbështetja e mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë përmes botimit, sigurimit të teksteve mësimore dhe materialeve plotësuese.”.

c) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. QBD-ja është përgjegjëse për:

a) botimin e teksteve dhe materialeve plotësuese që do t'i shërbejnë diasporës;

b) redaktimin përfundimtar të teksteve e të materialeve plotësuese që do të botohen;

c) nxitjen e aksesit *on-line* dhe të teksteve të veçanta për diasporën;

ç) nxitjen e krijimit të platformave digjitale të mësimdhënies dhe të formateve të posaçme për *e-Book*;

d) sigurimin e teksteve mësimore për diasporën, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara;

dh) mbulimin e shpenzimeve për shpërndarjen e teksteve mësimore e të materialeve plotësuese deri

në misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.”.

“3. Shtypja dhe sigurimi i teksteve mësimore dhe materialeve plotësuese, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, realizohet nga QBD-ja dhe shpenzimet përballohen nga buxheti i shtetit.”.

ç) Pikat 4 dhe 5 shfuqizohen.

d) Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1, 5/2 dhe 5/3, me këtë përmbajtje:

“5/1. Kërkesat për tekste mësimore e materiale plotësuese, si dhe sasia e tyre mbledhen nga misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendet pritëse të diasporës shqiptare. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme i dërgon këto kërkesa të përcaktuara sipas vendeve, brenda muajit maj të çdo viti, në Qendrën e Botimeve për Diasporën dhe për dijeni ministrisë përgjegjëse për arsimin. Qendra e Botimeve për Diasporën siguron me shpenzimet e saj dërgimin e teksteve mësimore e të materialeve plotësuese në misionet diplomatike, duke i kërkuar asistencë për bashkëpunim ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme e cila i siguron QBD-së, në funksion të lehtësimit të procedurave doganore, dërgimin e botimeve, si *cargo* diplomatike. Misioni diplomatik asiston në shpërndarjen e tyre drejt kërkuuesve të teksteve mësimore dhe materialeve plotësuese.

5/2. Nxënësit, që ndjekin mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, përfitojnë falas tekstet mësimore dhe materialet plotësuese të botuara dhe të siguruara nga Qendra e Botimeve për Diasporën.

5/3. Qendra e Botimeve për Diasporën përgatit informacionin vjetor për sasinë dhe mënyrën e shpërndarjes së teksteve mësimore e të materialeve plotësuese në diasporën shqiptare, të cilin e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.”.

dh) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. QBD-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e Qendrës dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për arsimin. Drejtori emërohet, pezullohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Drejtor i QBD-së emërohet shtetasi që plotëson kriteret e mëposhtme:

i. të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;



ii. të ketë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë apo të ketë diplomë ekuivalente me të, sipas ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në rast të përfundimit të studimeve jashtë vendit, të zotërojë diplomë të ciklit të dytë, të njohur dhe të njësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

iii. të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në fushën e librit ose botimit;

iv. të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

v. të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksioni publik me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë;

vi. të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

b) Drejtori i QBD-së pezullohet nga detyra, kur:

i. me vendim gjyqësor të formës së prerë vendoset masa e sigurimit personal ndaj tij; ose

ii. është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale.

c) Drejtori i QBD-së shkarkohet nga detyra në rastet e mëposhtme:

i. kur ndaj tij ka një vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente për kryerjen e një vepre penale që dënohet me burgim;

ii. për shkelje të rënda të ligjit;

iii. kur ka kryer veprimtari në kundërshtim me aktet nënligjore, të nxjerra nga ministri përgjegjës për arsimin;

iv. Për parregullsi të theksuara ose të përsëritura dhe me pasoja gjatë kryerjes së detyrës.

ç) Drejtori i QBD-së lirohet nga detyra në këto raste:

i. jep dorëheqjen;

ii. mbush moshën e pensionit;

iii. me vendim të komisionit mjekoligjor provohet paaftësia mendore ose fizike për kryerjen e detyrave;

iv. merret masa disiplinore e largimit nga puna.”.

e) Pikat 8, 8/1, 9 dhe 10 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“8. Pranë QBD-së funksionon Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si organ vendimmarrës për çështjet e botimeve dhe aktiviteteve për diasporën.”.

“8/1. Pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën funksionon Këshilli Koordinues i Arsimtarëve të Diasporës, si organ këshillimor për çështjet e

mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.”.

“9. Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën është organ kolegial, i përbërë nga pesë anëtarë, i cili ka përfaqësues nga:

a) ministria përgjegjëse për arsimin, dy anëtarë;

b) ministria përgjegjëse për punët e jashtme, një anëtar;

c) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, një anëtar;

ç) Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, një anëtar.”.

“10. Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën ka këto kompetenca:

a) Shqyrton kërkesat për botime për diasporën;

b) Miraton programet e botimeve të QBD-së, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me diasporën;

c) Shqyrton dhe miraton propozimet e QBD-së për botimin e teksteve të tjera e të materialeve plotësuese për diasporën, të cilat i njoftohen ministrisë përgjegjëse për arsimin;

ç) Shqyrton dhe miraton propozimet e QBD-së për përcaktimin e kostove të teksteve e të materialeve plotësuese për diasporën, të cilat i njoftohen ministrisë përgjegjëse për arsimin;

d) Planifikon shpërndarjen e teksteve e të materialeve plotësuese të botuara nga QBD-ja;

dh) Merr vendime për çështje të tjera, që lidhen me veprimtarinë e QBD-së.”.

ë) Pika 11 shfuqizohet.

f) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, me propozim të titullarit të institucionit përkatës. Ministri përgjegjës për arsimin cakton njërin nga anëtarët si kryetar të këtij Këshilli.

Anëtarët e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën përzgjidhen individë me përvojë pune në fushat e arsimit dhe diasporës.”.

g) Pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

“12/1. Këshilli mbledhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit. Mbledhja e Këshillit thirret me nismën e kryetarit të Këshillit. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën dy anëtarë të Këshillit ose nga drejtori i QBD-së.



Kërkesa duhet të përmbajë qëllimin, çështjet që do të diskutohen në mbledhje dhe materialet përkatëse.

Sekretari i Këshillit duhet të njoftojë anëtarët e Këshillit për mbledhjen, me postë elektronike ose me shkrim, 5 (pesë) ditë pune para datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit. Njoftimi për mbledhjen duhet të përmbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, si dhe materialin që do të shqyrtohet.

Rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën përcaktohen në rregulloren përkatëse të tij, e cila miratohet nga Këshilli.”

gj) Pika 13, 13/1, 13/2 dhe 13/3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“13. Anëtari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën shkarkohet në këto raste:

a) Kur lirohet ose shkarkohet nga funksioni që ushtronte në institucionin që përfaqëson;

b) Me propozim të titullarit të institucionit të përfaqësuar, për shkak të ndryshimit të misionit e të detyrave që ai kryen në atë institucion;

c) Kur neglizhon kryerjen e detyrave dhe pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën.”

“13/1. Këshilli Koordinues i Arsimitarëve të Diasporës është organ kolegjal, i përbërë nga 10 (dhjetë) anëtarë, të cilët përzgjidhen nga radhët e mësuesve me origjinë shqiptare që punojnë në diasporë, organizatorë të zhvillimit të mësimin të gjuhës shqipe në diasporë. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve të Diasporës emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, me propozim të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe diasporën. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Koordinues të Arsimitarëve të Diasporës realizohet sipas rregullave të parashikuara në rregulloren përkatëse të tij, e cila miratohet nga Këshilli.”

“13/2. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve të Diasporës janë mësues në diasporë dhe kanë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën e mësuesisë.”

“13/3. Këshilli mbledhet jo më pak se 1 (një herë) në muaj. Mbledhja e Këshillit thirret me nismën e kryetarit të Këshillit. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën dy anëtarë të Këshillit ose nga drejtori i QBD-së. Kërkesa duhet të përmbajë qëllimin, çështjet që do të diskutohen në mbledhje dhe materialet përkatëse.

Sekretari i Këshillit duhet të njoftojë anëtarët e Këshillit për mbledhjen, me postë elektronike ose me shkrim, 5 (pesë) ditë pune para datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit. Njoftimi për mbledhjen duhet të përmbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, si dhe materialet që do të shqyrtohen.”

h) Pikat 13/4, 13/5, 13/6 dhe 13/7 shfuqizohen.

i) Pas pikës 13/7 shtohet pika 13/8, me këtë përmbajtje:

“13/8. Këshilli Koordinues i Arsimitarëve të Diasporës ka këto kompetenca:

a) Jep informacione dhe mendime lidhur me çështjet e arsimit në gjuhën shqipe në diasporë si dhe bën propozime konkrete të lidhura me to;

b) Organizon në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, ministrinë përgjegjëse për arsimin, si dhe Qendrën e Botimeve për Diasporën takime me arsimtarët në diasporë;

c) Jep mendime për botime të teksteve nga QBD-ja për mbështetjen e mësimin të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë;

ç) Jep mendime për përmirësimin e zhvillimit profesional të mësuesve në diasporë dhe të mënyrës së bashkëpunimit me ta.”

j) Pikat 14, 15, 16 dhe 17 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“14. Ministri përgjegjës për arsimin, menjëherë pas shkarkimit të anëtarit, i kërkon institucionit të përfaqësuar në Këshillin Koordinues të Botimeve për Diasporën paraqitjen e emrit të kandidatit për anëtar të këtij këshilli.”

“15. Shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën kryhet, sipas rregullave të përcaktuara për shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegiale.”

“16. Struktura dhe organika e QBD-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për arsimin.”

“17. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe të sjelljes së personelit të Qendrës së Botimeve për Diasporën miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin, pas propozimit të drejtorit të saj.”

k) Pika 19 shfuqizohet.

l) Pikat 20 dhe 21 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“20. QBD-ja ka stemën dhe logon e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë”,



“Ministria e Arsimit dhe Sportit”, “Qendra e Botimeve për Diasporën””.

“21. Vula e QBD-së ka formën dhe elementet sipas rregullave të prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 77, datë 14.2.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE NË TURIZËM”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 325, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, emërtimet “Drejtori i Zhvillimit të Programeve të Turizmit” dhe “Drejtori i Projekteve Zhvillimore të Turizmit” zëvendësohen, përkatësisht, me “Drejtori i përgjithshëm Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse” dhe “Drejtori i përgjithshëm për Zhvillimin e Turizmit”.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 376, datë 28.12.2023

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN NËNTOR 2023, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2000/9 prot., datë 22.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin nëntor 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 8180 prot., datë 4.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2477 prot., datë 6.12.2023, shoqëria FSHU sh.a. ka përcjellë në ERE aplikimin mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të muajit nëntor 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Referuar nenit 81, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të nenit 9, pika 2, germa “e”, të “Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 247/2018, furnizuesi ka detyrimin të informojë në mënyrë të qartë klientët për elementet përbërëse të çmimit dhe kostot përkatëse.

- Për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, ERE merr në konsideratë vetëm komponentët e njohur sipas nenit 6, pika 3, pika 5, si dhe nenin 8, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së



energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017.

- Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, kostot e disbalancave llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e rregullave të tregut dhe akteve të tjera në fuqi. Referuar pikës 4.1.3.2, të “Rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, përcaktohet ndër të tjera se kostot e balancimit duhet të alokohen te shkaktarët e tyre në mënyrë të drejtë. Në këtë kuptim, përfshirja e këtyre kostove në tarifën e FMF-së devijon qëllimin për të cilin është krijuar dhe operon tregu i balancimit të energjisë elektrike, i cili është një treg konkurrues dhe që nuk operon me çmime të rregulluara.

- Mbështetur në nenin 8, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin nëntor 2023, janë: kostot administrative, tarifa e

shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar. Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të përlogaritura për aktivitetin e furnizimit vijnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 324, datë 14.12.2022, vijnë të jetë 1.55 lekë/kwh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2023, përlogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin nëntor 2023		
	Njësia	Çmimi
CBEt ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	13.40
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.40
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Leke/kWh 17.26

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 17.26 lekë/kwh për muajin nëntor 2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1.- Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin nëntor 2023, prej 17.26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 377, datë 26.12.2023****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E “METODOLOGJISË MBI
PËRCAKTIMIN E DETYRIMIT PËR
ENERGJINË E RINOVUESHME”**

Në mbështetje të nenit 16, pika 8, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”; të nenit 19, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të neneve 19 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2527 prot., datë 26.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë për përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Metodologjia ka për qëllim të përcaktojë përlllogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike, sikurse përcaktuar në ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”.

- Akti i hartuar është i përberë nga tre pjesë (dispozita të përgjithshme, metodologjia për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe dispozita të fundit) dhe ka në tërësi 14 nene.

- Në pjesën e tretë të metodologjisë, përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (OER) dhe ERE-s (neni 4), furnizuesve të energjisë elektrike (neni 5), parashikimi vjetor i energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi (neni 6), llogaritja e detyrimit për energjinë e rinovueshme (neni 7), faturimi dhe pagesa e detyrimit për energjinë e rinovueshme dhe mbështetjen për prodhuesit me përparësi (neni 8), rregullat e detyrimit të energjisë së rinovueshme (neni 9) si dhe kufiri maksimal për instrumentet afatshkurtër për likuiditet nga furnizuesit dhe nga OER-ja (neni 10).

- Në dispozitat kalimtare, metodologjia ka përcaktuar rishikimin e jashtëzakonshëm kur ka një

devijim të tepruar ndërmjet vlerave të parashikuara dhe të realizuara për qëllimin e llogaritjes së detyrimit për energjinë e rinovueshme, sipas neneve 7 dhe 9, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve kontraktuale, rishikimin dhe ndryshimin e metodologjisë dhe hyrjen në fuqi të saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 378, datë 28.12.2023****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E “RREGULLORES PËR
LËSHIMIN, TRANSFERIMIN,
TËRHEQJEN DHE ANULIMIN E
GARANCIVE TË ORIGINËS PËR
ENERGJINË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA BURIMET E
RINOVUESHME”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-



s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2330/3 prot., datë 26.12.2023, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”,

konstatoi se:

- Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, është hartuar në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 64, datë 14.4.2023, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas këtij botimi.

- Në nenin 22, pika 2 e këtij ligji përcaktohet se: “ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës në Republikën e Shqipërisë dhe siguron përafrimin e politikave dhe primeve të garancisë së origjinës me sistemet e certifikatave të njohura në Komunitetin e Energjisë.”.

- Po ashtu, në nenin 22, pika 14 e këtij ligji është parashikuar se: “ERE duhet t’i bashkohet sistemit rajonal të komunitetit të energjisë për të mundësuar tregtimin e garancive të origjinës me palët e tjera kontraktuese të komunitetit të energjisë.”.

- Ky detyrim është përmbushur nga ERE me nënshkrimin e marrëveshjes për regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancisë së origjinës.

- Në nenin 22, pika 1, të këtij ligji përcaktohet, ndër të tjera, se: “ERE miraton rregullat për lëshimin e garancive të origjinës dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të garancive të origjinës.”.

- Në zbatim të këtij përcaktimi është draftuar “Rregullorja për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

- Në hartimin e kësaj rregulloreje janë marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, specifikat e sistemit rajonal të

garancive të origjinës dhe elementet e regjistrit elektronik të GO-ve.

- Rregullorja përbëhet nga 26 nene, të cilat përcaktojnë kryesisht kërkesat dhe procedurat e ndjekura për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, në përputhje me regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancive të origjinës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

2. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 381, datë 28.12.2023

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
S PËR APLIKIMIN E SHOQËRISË
“DRINI BULQIZË” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin,



njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2417/9 prot., datë 22.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë ‘Drini Bulqizë’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2416 prot., datë 17.11.2023, ka paraqitur aplikimin për pajisje me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, në pellgun ujëmbledhës mbi tri degëzimet e Përroit të Neshtës, Degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

- Bordin i ERE-s me vendimin nr. 354, datë 1.12.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 2.12.2023 dhe 4.12.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 11.12.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2417/5 prot., datë 7.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e bordit nr. 354/2023 duke evidentuar dhe dokumentacionin/informacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2417/6 prot., datë 11.12.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet e gjithashtu të sqarohet një pjesë e këtij dokumentacioni me shoqërinë, ndaj me shkresën nr. 2417/8 prot., datë 19.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e ERE-s në datën 28.12.2023.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, parashikohet se Bordin mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për gjithë sa më sipër, në rrethanat kur është planifikuar seanca dëgjimore me shoqërinë e po ashtu duke marrë në konsideratë faktin se gjatë kësaj periudhe ka disa pushime zyrtare e po ashtu nevojitet koha për të shqyrtuar dokumentacionin që do të depozitohet në vijim nga shoqëria, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrja përfundimtare e Bordit për aplikimet e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordin i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1,751 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 382, datë 28.12.2023

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s PËR APLIKIMIN E SHOQËRISË
“DRINI BULQIZË” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2417/9 prot., datë 22.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë ‘Drini Bulqizë’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2417 prot., datë 17.11.2023, ka paraqitur aplikimin për pajisje me licencë për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 355, datë 1.12.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 2.12.2023 dhe 4.12.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 11.12.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2417/5 prot., datë 7.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e Bordit nr. 354/2023 duke evidentuar dhe dokumentacionin/informacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2417/6 prot., datë 11.12.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet e gjithashtu të sqarohet një pjesë e këtij dokumentacioni me shoqërinë, ndaj, me shkresën nr. 2417/8 prot., datë 19.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e ERE-s në datën 28.12.2023.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*

- Për gjithë sa më sipër, në rrethanat kur është planifikuar seanca dëgjimore me shoqërinë e po ashtu duke marrë në konsideratë faktin se gjatë kësaj periudhe ka disa pushime zyrtare e po ashtu nevojitet koha për të shqyrtuar dokumentacionin që do të depozitohet në vijim nga shoqëria, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrja përfundimtare e Bordit për aplikimet e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 386, datë 28.12.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALPIQ
ENERGY ALBANIA” SHPK PËR
HEQJEN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, germa “dh”, 7, paragrafi 2, dhe nenit 9, germa “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 9.1, germa “a” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e furnizimit të Energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1450/3 prot., datë 22.12.2023, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Alpiq Energy Albania’ sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 291, seria FK15/F20, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.5.2015, rinovuar me vendimin nr. 80, datë 4.5.2020, për një afat 5-vjeçar (deri më 4.5.2025).

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 342, datë 14.11.2023, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e kësaj licence, për arsye se shoqëria nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2023 dhe nuk kishte depozituar asnjë dokument

apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim me shkresën nr. 1450/2 prot., datë 21.11.2023, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2500 prot., datë 13.12.2023, shoqëria ka paraqitur kërkesën për heqjen e kësaj licence, pasi ka vendosur mbylljen e veprimtarisë dhe nisjen e procedurave të likuidimit, duke marrë angazhimin për të shlyer sa më shpejt pagesën rregullatore.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (*statement*) të ERE-s rezulton se kjo debi është shlyer në datën 14.12.2023, ndaj ajo nuk rezulton më debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit.

- Në nenin 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, germa “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe pikën 9.1, germa “a” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.6.2016, përcaktohet se: *ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.*

- Në nenin 7, paragrafi 2 i rregullores së sipërcituar përcaktohet se: *Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, germa “d” të kësaj rregulloreje parashikohet se... Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.*

- Duke qenë se tashmë ndryshojnë rrethanat/shkaqet për të cilat u mor vendimi i Bordit nr. 342/2023, vlerësohet të vijohet me procedurën e heqjes së licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, por duke miratuar kërkesën e saj për heqjen e kësaj licence, sipas përcaktimeve ligjore si më lart cituar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 291, seria FK15/F20, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.5.2015, rinovuar me vendimin nr. 80, datë 4.5.2020.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. dhe shoqërinë “Operatori të Sistemit të Transmetimit” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 389, datë 28.12.2023

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR HEQJEN E
LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË
“SHUTINA ENERGJI” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 7, 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe

procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2311/2 prot., datë 22.12.2023, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi përfundimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare për pagesat e rregullimit të vitit 2023 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Bordin të ERE-s, me vendimin nr. 325, datë 14.11.2023, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k.

- Vendimi i mësipërm u mor për arsye se shoqëria nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2023 për licencën për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike e po ashtu nuk kishte depozituar asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 1668/2 prot., datë 21.11.2023, shoqëria është njoftuar për vendimin e Bordit të ERE-s nr. 325/2023, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (*statement*) të ERE-s rezulton se kjo debi është shlyer në datën 4.12.2023.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar subjektit, rezulton se shoqëria “Shutina Energji” sh.p.k. i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitoare ndaj ERE-s.

- Në nenin 9, germa “a” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017 parashikohet se: *Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordin do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës.*

- Në nenin 95 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur. Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% vlerës së debisë nga shoqëria “Shutina Energji” sh.p.k.*



- Vërtetimi i shlyerjes së pagesës së prapambetur, fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkaktuar që çoi në marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës dhe duke qenë se objekti për të cilin filloi procedura për heqjen e licencës së të licencuarit nuk ekziston më, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 325/2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 325, datë 14.11.2023, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k”.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 325, datë 14.11.2023.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Shutina Energji” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

